



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi teksti

Ngarkesa: numri i krediteve 4, leksione 20 orë, seminare 20orë
Viti / Semestri : Viti III, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Francez
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda synon objektivat e mëposhtme: përshkrimin sistematik të objektit të gjuhësisë së tekstit; Pikëpamjet e ndryshme mbi tekstin; Përkufizimin e tekstit, dallimet mes tij, diskursit dhe gjinisë; Vendi i analizës së tekstit në analizën e diskursit; Rregullat e koherencës, kohezionit dhe mjetet e realizimit të tyre; Organizatorët tekstore (konektorët); Studimin e tipave të ndryshëm të teksteve.

Objektivat specifike lëndore:

- 1) të përcaktojë vendin e gjuhësisë së tekstit dhe rëndësisë së saj;
- 2) të përcaktojë marrëdhëniet e saj me disiplinat e tjera të gjuhësisë;
- 3) të paraqesë kompleksitetin e tekstit;
- 4) të orientojë studentët në analizën e teksteve të ndryshme ;
- 5) t'i aftësojë ata në krijimin dhe përdorimin e tipave të ndryshme të teksteve.